



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e statistikës

Shkup, 28 mars 2025

Njoftim për shtyp

Lëvizjet më të rëndësishme të normat e interesit të bankave dhe kursimoreve¹: shkurt 2025

- Në shkurt 2025, norma mesatare e interesit e totalit të kredive është 5,18% dhe shënoi rënie mujore dhe vjetore prej 0,03 p.p. dhe respektivisht 0,34 p.p. Norma mesatare e interesit të totalit të depozitave është rritur në nivel mujor për 0,01 p.p., me rritje vjetore prej 0,43 p.p. dhe shënon 2,19%.
- Në shkurt, norma mesatare e interesit e kredive të sapo miratuara² është ulur për 0,07 p.p. dhe përkatësisht 0,72 p.p. në bazë mujore dhe vjetore, dhe shënon 4,63%. Norma mesatare e interesit për depozitat të sapo pranuar është ulur për 0,07 p.p. dhe shënon 2,41%, me rritje vjetore prej 0,10 p.p.

Tabela 1. Normat e interesit të depozitave dhe kredive të reja në total

	2.2024	3.2024	4.2024	5.2024	6.2024	7.2024	8.2024	9.2024	10.2024	11.2024	12.2024	1.2025	2.2025
në % në bazë mujore													
Totali i kredive	5.52	5.50	5.51	5.49	5.47	5.46	5.44	5.41	5.38	5.36	5.30	5.21	5.18
Korporatat	5.40	5.65	5.35	5.31	5.26	5.23	5.20	5.15	5.09	5.05	4.96	4.85	4.82
Amviseritë	5.64	5.35	5.65	5.65	5.66	5.67	5.66	5.66	5.66	5.66	5.63	5.55	5.53
Kreditë e reja	5.35	4.98	5.47	5.19	5.08	5.12	5.04	4.98	4.81	4.82	4.42	4.70	4.63
Korporatat	5.25	5.40	5.57	5.16	4.95	4.96	4.90	4.78	4.65	4.68	4.39	4.65	4.45
Amviseritë	5.45	4.73	5.33	5.26	5.29	5.34	5.28	5.27	5.17	5.03	4.47	4.76	4.81
Depozitat	1.76	1.80	1.82	1.86	1.88	1.93	1.96	2.01	2.07	2.12	2.17	2.18	2.19
Korporatat	2.08	1.76	2.11	2.21	2.25	2.28	2.20	2.34	2.42	2.68	2.69	2.69	2.71
Amviseritë	1.73	2.12	1.79	1.81	1.84	1.89	1.93	1.97	2.02	2.05	2.10	2.11	2.12
Depozitat e reja	2.31	2.46	2.54	2.36	2.52	2.76	2.43	2.60	2.84	2.80	2.78	2.48	2.41
Korporatat	2.19	2.42	2.61	2.38	2.39	3.03	1.99	2.14	2.75	2.43	2.59	2.56	2.49
Amviseritë	2.35	2.52	2.52	2.36	2.55	2.68	2.76	2.79	2.89	2.88	2.83	2.46	2.38

Burimi: BPRMV-ja.

¹ Me termin "normë interesi" nënkuptohet norma e ponderuar mesatare e interesit e shprehur në përqindje në bazë vjetore. Për shpjegim më të hollësishëm shihni Metodologjinë

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia_MIR_07_2018_mak.pdf



² Në lidhje me normat e interesit të kredive të sapo miratuara / depozitave të sapo pranuar janë karakteristike lëvizje të ndryshueshme. Lëvizjet e këtyre normave të interesit janë si rezultat i ndryshimeve në vëllimin e depozitave/kredive të reja (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshojnë konsiderueshëm), si dhe nga norma e re e rënë dakord e interesit.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e statistikës



1. Norma të interesit në sektorin korporativ³

- Norma mesatare e interesit të totalit të kredive të sektorit korporativ, në shkurt në shënoi rënie mujore prej 0,03 p.p. dhe shënon 4,82%. Analizuar sipas valutës, rënia rezulton nga ulja e normave të interesit të kredive në valutë të huaj (për 0,05 p.p.) dhe të normave të interesit të kredive në denarë pa klauzolë valutore (për 0,04 p.p.), me rritje të normave të interesit të kredive në denarë me klauzolë valutore (për 0,03 p.p.). Në bazë vjetore, kjo normë e interesit shënon rënie prej 0,58 p.p.



Burimi: BPRMV-ja.

- Në shkurt, norma e interesit e kredive të sapo miratuara të sektorit korporativ është ulur për 0,20 p.p. në bazë mujore dhe është 4,45%. Ndryshimi vjen si pasojë e rënies së normave të interesit për të gjithë komponentët dhe atë: normat e interesit të kredive në denarë pa dhe me klauzolë valutore (për 0,27 p.p. dhe për 0,07 p.p., përkatësisht) dhe normat e interesit të kredive në valutë të huaj (për 0,04 p.p.). Analizuar në bazë vjetore, norma e interesit për kreditë e sapo miratuara në sektorin korporativ është ulur për 0,80 p.p.



Burimi: BPRMV-ja.


³ Për nevojat e këtij njoftimi, sektori korporativ përfshin institucionet jo-financiare (publike dhe të tjera).




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e statistikës

- Në shkurt, norma mesatare e interesit e totalit të depozitave të sektorit korporativ arrin 2,71% dhe shënon rënie mujore prej 0,02 p.p. Ndryshimi është rezultat i rritjes së normave të interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,19 p.p.) dhe të normave të interesit të depozitave në denarë me klauzolë valutore (për 0,05 p.p.), ndërsa normat e interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore shënuan rënie (për 0,03 p.p.). Në nivel vjetor, norma e interesit e totalit të depozitave të sektorit korporativ shënoi rritje për 0,63 p.p.
- Norma e interesit të depozitave të sapo pranuar⁴ të sektorit korporativ, këtë muaj, është ulur për 0,07 p.p. në bazë mujore dhe shënon 2,49%. Ulja vjen si pasojë e normave më të ulëta të interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,17 p.p.) dhe normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore (për 0,06 p.p.). Njëkohësisht, norma e interesit e depozitave në denarë me klauzolë valutore është 2,50%, krahasuar me muajin paraprak kur bankat dhe kursimoret nuk kanë pranuar depozita të këtij lloji. Norma e interesit të depozitave të sapo pranuar⁵ të sektorit korporativ është rritur për 0,30 p.p. në nivel vjetor.

2. Norma të interesit për amvisëritë⁶



Burimi: BPRMV-ja.



- Në shkurt 2025, norma e interesit e totalit të kredive të amvisërive shënoi rënie mujore prej 0,02 p.p. dhe është 5,53%. Rënia mujore vjen si pasojë e rënies së normave të interesit për të gjithë komponentët dhe atë: normat e interesit të kredive në denarë pa dhe me klauzolë valutore (për 0,04 p.p. dhe për 0,01 p.p., përkatësisht) dhe normat e interesit të kredive në valutë të huaj (për 0,01 p.p.). Krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar, kjo normë e interesit është ulur për 0,11 p.p.

⁴ Në grafikun që i referohet normave të interesit për depozitat e reja të sektorit korporativ, ndërprerja në seritë e të dhënave të normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është si rezultat i asaj që në muaj të caktuar bankat dhe kursimoret nuk kanë pranuar lloj të atillë të depozitave nga sektori korporativ.


⁵ Në grafikun që i referohet normave të interesit për depozitat e reja të sektorit korporativ, ndërprerja në seritë e të dhënave të normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është si rezultat i asaj që në muaj të caktuar bankat dhe kursimoret nuk kanë pranuar lloj të atillë të depozitave nga sektori korporativ.

⁶Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë përfshijnë: persona fizik, ekzekutues të pavarur të veprimtarisë dhe institucione jofitimprurëse të cilët u shërbejnë amvisërive.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e statistikës

- Norma mesatare e interesit të kredive të sapo miratuara të amvisërive, në shkurt, është 4,81% dhe është rritur për 0,05 p.p. në nivel mujor. Rritja është rezultat i normave më të larta të interesit për kreditë në valutë të huaj (për 0,22 p.p.) dhe të normave të interesit të kredive në denarë me klauzolë valutore (për 0,03 p.p.), ndërsa normat e interesit kredive në denarë pa klauzolë valutore janë reduktuar (për 0,05 p.p.). Analizuar në nivel vjetor, norma e interesit për kreditë e sapo miratuara të amvisërive shënon rënie për 0,64 p.p.



Burimi: BPRMV-ja.



- Në shkurt, norma e interesit e totalit të depozitave të amvisërive është 2,12% dhe shënoi rritje mujore prej 0,01 p.p. Rritja mujore vjen nga rritja e të gjitha komponentave: normat e interesit të depozitave në denarë pa dhe me klauzolë valutore dhe të normave të interesit të kredive në valutë të huaj (për 0,01 p.p.). Në krahasim me muajin shkurt të vitit të kaluar, kjo normë e interesit është rritur për 0,39 p.p.
- Këtë muaj, norma e interesit e depozitave të sapo pranuar të amvisërive⁷ shënoi rënie mujore prej 0,08 p.p. dhe shënon 2,38%. Rënia është tërësisht rezultat i uljes së normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore (për 0,17 p.p.), në kushtet e rritjes së normave të interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,08 p.p.). Te bankat dhe kursimoret, në shkurt, nuk janë regjistruar depozita të sapo pranuar në denarë me klauzolë valutore. Në nivel vjetor, norma e interesit e depozitave të sapo pranuar të amvisërive është më e lartë për 0,03 p.p.

⁷ Në grafikun që u referohet normave të interesit të depozitave të sapo pranuar të amvisërive, ndërprerja e serive e të dhënave në normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është për shkak të faktit që në muaj të caktuar bankat dhe kursimoret nuk kanë pranuar depozita të amvisërive të këtij lloji.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e statistikës

Informacione mbështetëse

Seri kohore e të dhënave: të dhëna vjetore, tremujore dhe mujore për normat e ponderuara të interesit të bankave dhe kursimoreve

https://www.nbrm.mk/statistika_na_kamatni_stapki-al.nspix

Shpjegime metodologjike:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologija/Metodologija_MIR_07_2018_mak.pdf

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave

https://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_i_publicimit_t%C3%AB_t%C3%AB_dh%C3%ABnave.pdf

Të dhëna mujore për normat e interesit: 30 prill 2025 (mesatare referuese, përfshirë marsin e vitit 2025).

Për pyetje të gazetarëve, ju lutemi kontaktoni me personat nga Kabineti i Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme në lidhje me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit lokal 02/3215-235. 108/110.